

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

Tezë Masteri

**“MENAXHIMI PRINDËROR I PËRDORIMIT TË TIK-UT NGA FËMIJËT E TYRE:
RAST STUDIMI KOMUNA E STRUGËS”**

Kandidati:

Bekim Doko

Mentor:

Prof.Dr. Sadri Alija

Tetovë, Dhjetor 2021

Kjo tezë është përpiluar për mbrojtjen e titullit të Masterit në drejtimin e Ekonomisë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të riprodhohet pa leje të autorizuar nga autori.

This thesis is for a M.Sc. degree in Economy and may not be reproduced in any form without the written permission of the author.

© Bekim Doko, 2021

DEKLARATË STATUORE:

Nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Falënderime

Së pari, falënderimi i takon zotit që më mundësoi të përfundoj studimet në drejtimin e Ekonomisë me shëndet të plotë dhe me sukses.

Faleminderit të gjithë dashamirëve, të cilët besuan shumë në mua dhe kanë qenë shtysë e madhe që të vazhdoj vetëm para, drejt suksesit.

Në menyrë të veçantë falënderoj mentorin tim Prof.dr. Sadri Alija, i cili më ka ndihmuar shumë në finalizimin me sukses të studimeve të mia..!

Pafundësisht mirënjohës për familjen time, prindërit e mi të cilët, kanë qenë mbështetja ime më e madhe morale dhe financiare, e të cilëve edhe ua dedikoj këtë sukses...

Faleminderit që të gjithëve që jeni në jetën time dhe pjesë e gëzimeve dhe arritjeve të mia...!

Përmbajtja

Abstrakti.....	9
Abstract.....	10
KAPITULLI I PARË.....	11
1. HYRJE.....	11
1.1. Rëndësia e punimit	11
1.2. Identifikimi i problemit	12
1.3. Qëllimi i punimit.....	15
1.4. Hipotezat e hulumtimit	15
KAPITULLI I DYTË	17
2. Shqyrtimi i literaturës për fëmijët në botën virtuale	17
2.1. Fillesat e internetit	17
2.2. Teknologjia dhe zhvillimi i fëmijëve ne botën virtuale	20
2.3. Strategjitë prindërore për ndërmjetësim	22
2.4. Kuadri ligjor rregullator për komunikimin virtual	24
2.4.1. Akte të OKB-SË:.....	25
2.4.2. Akte të Këshillit të Evropës	25
2.4.3. Përkufizime shtesë	25
KAPITULLI I TRETË	27
3. Metodologjia e hulumtimit	27
3.1. Popullata e studimit	28
3.2. Instrumentet e kërkimit	28
3.3 Etika.....	28
3.4. Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave	28
KAPITULLI I KATËRT	30
4. Rezultatet e hulumtimit	30
4.1. Të dhënat socio-demografike	30
4.2. Informacioni i prindërve rreth përfshirjes së fëmijëve në botën viruale.....	33
4.3. Mosha e fillimit të përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale nga fëmijët	37
4.4. Koha e shpenzuar nga fëmijët në internet dhe rrjete sociale (në ditë)	38

4.5. Njohuritë mbi kontrollet prindore dhe efektet që shkakton bota virtuale tek fëmijët	38
4.6. Testimit i hipotezave	41
.....	45
KAPITULLI I PESTË.....	45
5. Diskutime, konkluzione dhe rekomandime	45
5.1. Diskutime	45
5.2. Përfundime dhe rekomandime	50
Referencat.....	52

Lista e grafikoneve dhe figurave

Figura 1: Përdoruesit e internetit për 100 banorë në botë	19
Figura 2: Teoria e sistemeve ekologjike.....	21
Figura 3: Përdorimet dhe teoria e kënaqësisë (UGT)	22
Figura 4: Zhvillimi i adoleshentëve në mjedisin e sotshëm	23
Grafiku 1: Shkollimi i prindërve	31
Grafiku 2: Gjinia e të anketuarve	31
Grafiku 3. Punësimi i të anketuarëve.....	32
Grafiku 4: Gjinia e fëmijës.....	32
Grafiku 5: Niveli i përfshirjes së adoleshentëve në botën virtuale	33
Grafiku 6. Posedimi i telefonit celular tek fëmijët	33
Grafiku 7. Posedimi i rrjeteve sociale nga ana e adoleshentëve	34
Grafiku 8. Njohuria e prindërve në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës.....	35
Grafiku 9. Përdorimi i TIK nga prindërit	35
Grafiku 10. Shpeshësia e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës brenda ditës	36
Grafiku 11. Shpeshësia e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës brenda javës.....	36
Grafiku 12. Mosha e fëmijës që përdor internetin	37
Grafiku 14. Orët e harxhuara në internet nga fëmijët.....	38
Grafiku 15. Shqetësimi i prindërve për karakterin e informatave që mund të hasen nga fëmijët në internet.....	39
Grafiku 16. Njohuria e prindërve në lidhje me ekzistimin e programeve të posaçëm për kontrollin e aktivitetit online	39
Grafiku 17. Opinioni i prindërve në lidhje me ndikimin e internetit në sjelljen e fëmijës	40
Figura 5:Përballja e mundësive të ofruara nga teknologjia me kulturën e përfitimit të tyre ..	50

Lista e tabelave

1

Tabela 1: Rezultatet e hipotezës së parë	42
Tabela 2: Rezultatet e hipotezës së dytë.....	42
Tabela 3: Rezultatet e hipotezës së tretë.....	43
Tabela 4: Rezultatet e hipotezës së katërt	44

Abstrakti

Mosha e adoleshencës paraqet një rezonancë të veçantë në lidhje me botën virtuale. Shumë studime, përfshirë edhe këtë studim, sugjerojnë se gjatë viteve që adoleshentët zhvillohen në mënyrë intensive prania e botës virtuale përvijon forma të reja sjelljeje. Interneti dhe rrjetet sociale, si pjesë e botës virtuale, kanë një kuptim specifik për adoleshentët, mënyrat e ndryshme të perceptimit dhe ndjenjat që krijohen mes realitetit dhe virtualitetit bëhen bashkëshoqëruese të adoleshentëve në këtë qasje të re teknologjike. Kur ky modalitet nuk arrin të harmonizojë këtë balancë, atëherë shqetësimi për efektet e tij në jetën e adoleshentëve bëhet evident. Në të njëjtën kohë “bota e të rriturve” është gjithnjë e prirur që angazhimin e adoleshentëve në botën virtuale ta shohë me rezerva për shkak të debateve në lidhje me ndikimin e saj në mirëqenien e tyre. Njohja e situatës aktuale, analizuar në përballjen teorike dhe studimore mundëson qartësimin e ideve për këtë evolucion globalizimi. Qëllimi i studimit ishte të vlerësonte marrëdhënien ndërmjet nivelit të përfshirjes së adoleshentëve në botën virtuale, efektet që ajo shkakton në sjelljen e tyre, rolin që luajnë prindërit dhe punonjësit social në këtë proces. Ky është një studim i cili, me anë të metodës sasiore të grumbullimit të të dhënave përshkruan dhe analizon situatën aktuale të përfshirjes të adoleshentëve në botën virtuale, njohurië e prindërve rreth rrëziqueve potenciale, përdorimin e teknologjive të informimit dhe komunikimit dhe me anë të grafikoneve dhe programeve të veqanta analizaum të dhënat të cilat do ti shfaqim në punim.

Fjalët kyçe: TIK, Adoleshentët, Prindërit, Interneti.

Abstract

Adolescence presents a special resonance in relation to the virtual world. Many studies, including this one, suggest that during the years that adolescents develop intensively the presence of the virtual world outlines new forms of behavior. The Internet and social networks, as part of the virtual world, have a specific meaning for adolescents, the different ways of perception and the feelings that are created between reality and virtuality become companions of adolescents in this new technological approach. When this model fails to harmonize this balance, then the concerns about its effects on adolescent life become evident. At the same time, the "adult world" is increasingly reluctant to view adolescents' engagement in the virtual world with reservations due to debates about its impact on their well-being. Knowledge of the current situation, analyzed in the theoretical and study confrontation enables the clarification of ideas for this evolution of globalization. The purpose of the study was to assess the relationship between the level of involvement of adolescents in the virtual world, the effects it causes on their behavior, the role played by parents and social workers in this process. This is a study which, through the quantitative method of data collection, describes and analyzes the current situation of adolescents 'involvement in the virtual world, parents' knowledge about potential risks, the use of information and communication technologies and through charts and special analyzing programs the data will be displayed .

Key words: ICT, Adolescent, Parents, Internet

KAPITULLI I PARË



1. HYRJE

1.1. Rëndësia e punimit

Interneti dhe rrjetet sociale janë pjesë e rëndësishme e jetës së adoleshentëve. Studime të ndryshme tregojnë se për adoleshentët e sotëm interneti nuk është vetëm një mjedis virtual por një pjesë e rëndësishme e jetës së tyre reale. Adoleshentët e sotëm janë duke jetuar në një botë ku përdorimi i internetit është një pjesë e jetës së tyre të përditshme. Në këto kushte, është e rëndësishme që, përveç njohjes së karakteristikave të adoleshencës dhe fazave të cilave ato i kalojnë nga dita në ditë, ta kuptojmë zhvillimin fizik dhe social si dhe ta studiojmë aspektin kontekstual në të cilin të rinjtë jetojnë dhe nga i marrin eksperiencat. Në Këshillin e Forumit Pan-European të Europës (2006) për të Drejtat e Njeriut në Shoqërinë e Informacionit, “Fuqizimi i fëmijëve dhe adoleshentëve”, është theksuar se: Interneti është bërë pjesë e botës reale.

Ky studim është i rëndësishëm, sepse interneti dhe rrjetet sociale duket se kanë pasur një ndikim shumë më të madh dhe shumë serioz mbi shoqërinë dhe veçanërisht adoleshentët.

Ky ndikim ndihet në shumë aspekte në jetën e adoleshentëve, si në atë personale, familjare, në shkollë, në marrëdhënie me bashkëmoshatarët etj.

Studimi është i rëndësishëm sepse në Republikën e Maqedonisë Veriore ka pak studime në këtë fushë, megjithëse përfshirja e të rinjve vitet e fundit në botën virtuale është një fakt i njohur por, jo i studiuar.

Gjetjet e studimit shërbejnë për ta ndërgjegjësuar mbarë shoqërinë për detyrimin që kemi për t'i ndihmuar adoleshentët në krijimin e një identiteti personal të unifikuar dhe konstruktiv.

Vlerësimi i ndikimit që sjell bota virtuale në sjelljen e adoleshentëve është i rëndësishëm sepse paraqet një pasqyrë reale të situatës dhe i ndërgjegjëson prindërit, profesionistët, institucionet arsimore për nevojën për të ndërhyrë në nivele të ndryshme.

1.2. Identifikimi i problemit

Shoqëria bashkëkohore është në një proces masiv ndryshimi, të quajtur dixhitalizim. Një pjesë e modeleve të komunikimit dhe të sjelljes ekzistuese po ripërcaktohen, po riintegrohen në një qasje teknologjike me përmbajtje të re, të përshtatur me profilin bashkëkohor të një shoqërie në ndryshim. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit ka kapërcyer kufijtë gjeografik dhe territoret, duke i dhënë jetës një dinamikë të re. Sa i përket përdorimit të internetit, Evropa është rajoni me depërtimin në shkallën më të lartë të internetit në botë 75%, e në vend të dytë vjen SHBA me 61%. (ITU).

Struktura e internetit është radikalisht e ndryshme nga ajo e sistemeve të centralizuara ose pjesërisht të “decentralizuara”. Interneti (përkundrazi) është një rrjet “i shpërndarë” njëlloj, në të cilin çdo nyje mund të lidhet me cilëndo nyje tjetër e të zgjedhë, sipas rastit, rrugën më të përshtatshme. Kjo strukturë e veçantë ndërtimi e bën atë të ndryshëm, duke nënkuptuar faktin se ai nuk ka një pikë qendrore. Secila prej nyjeve të tij të “pafundme” mund të jetë dhe qendra e tij, kështu që nuk ekziston kurrfarë “zotërie i quajtur internet”, që t’i diktojë apo kontrollojë opinionet, sjelljet apo qëndrimet në rrjet.

Komunikimi është një proces shkëmbimi informacioni, dhënie e marrje mesazhi midis dy ose disa individëve. Është një proces jetik për ekzistencën e marrëdhënieve shoqërore, ndërpersonale midis individëve.

Natyrisht, kjo përhapje e shpejtë e internetit ka ndikimin e saj në të gjithë popullsinë, por veçanërisht tek të rinjtë për shkak të karakteristikave që ka kjo grupmoshë. Problemi thellohet edhe më shumë me faktin e mosnjohjes së mënyrave se si e përdorin internetin adoleshentët. Kjo moshë është quajtur moshë delikate, sepse problemet që hasen në adoleshencë ndërthuren e integrohen si në aspektin fizik dhe fiziologjik ashtu dhe në atë psikologjik dhe social. Njohja e efektit që ka interneti në jetën e adoleshentëve është kthyer në ditët e sotme në një çështje, e cila duhet studiuar, duke marrë për bazë dy veçoritë e ndryshme të internetit si një medium i personalizuar përkundrejt një ambienti interaktiv. Për shkak të këtyre implikimeve dhe pasojave që ato sjellin në sjelljen e adoleshentëve, studimi dhe analiza e tyre është e domosdoshme.

Prindërit kanë një sërë shqetësimesh se si aktivitetet online të fëmijëve të tyre mund të ndikojnë në privatësinë e tyre dhe shumë prej tyre kanë ndërmarrë masa për të vëzhguar fëmijët e tyre dhe për të rritur sigurinë e tyre në internet.

Fëmijët dhe adoleshentët e sotëm janë të zhytur në forma tradicionale dhe të reja të mediave dixhitale. Kërkimet mbi mediat tradicionale, si televizioni kanë identifikuar shqetësimet shëndetësore dhe rezultatet negative që lidhen me kohëzgjatjen dhe përdorimin e televizionit. Gjatë dekadës së fundit për përdorimin i mediave dixhitale dhe sociale janë bërë shumë punime dhe studime, të cilat sugjerojnë se këto media më të reja ofrojnë si përfitime, ashtu edhe rreziqe për shëndetin e fëmijëve dhe të adoleshentëve (Loprinzi PD, Davis R. E.2016).

Studimet tregojnë se përdorimi i mediave sociale midis fëmijëve dhe adoleshentëve ka vazhduar të rritet në mënyre rapide gjatë dekadës së fundit, të ndihmuar pjesërisht nga rritja e fundit e përdorimit të telefonave celularë, rrjeteve sociale si dhe aplikacioneve të ndryshme midis fëmijëve dhe adoleshentëve. Tani, afërsisht tre të katërtat e adoleshentëve zotërojnë një smartphone, 24% e adoleshentëve e përshkruajnë veten si "vazhdimisht të lidhur" me Internetin dhe 50% raportojnë se ndihen të "varur" nga telefonat e tyre. (Felt LJ, Robb MB, 2016).

Videolojërat gjithashtu mbeten shumë të popullarizuara në mesin e adoleshentëve; Është vlerësuar se 4 nga 5 familje zotërojnë një pajisje që përdoret për të luajtur lojëra elektronike dhe afërsisht gjysma e shtëpive të SHBA zotërojnë një konsolë të dedikuar për videolojë. Videolojërat janë gjithashtu në dispozicion nëpërmjet aplikacioneve tek pajisjet si telefonat, tabletat dhe konsollat e ndryshme. Egziston një qasje e njohur si "gamification" e cila në thelb kuptimin e saj e ka të shtuarën e lojërave në ambiente ku ata nuk ekzistojnë si : webfaqet komunitete online, etj (Entertainment Software Association. 2015) .

Prania e televizorit, lojërave elektronike dhe internetit në dhomën e gjumit padyshim që kanë ndikuar në këtë proces. Në një studim të vitit 2004 me 2.546 adoleshentë belg u zbulua se, ata që kishin televizor në dhomat e tyre të gjumit, binin në shtrat më vonë ditët e javës dhe shumë më vonë në fundjavë. Ata të rinj që shpenzonin shumë kohë në internet, binin të flinin më vonë, kështu që raportonin një lodhje më të madhe (Van den Bulck , 2004).

Është e zakonshme që adoleshentët sot të angazhohen në më shumë se një formë të mediave në të njëjtën kohë, një praktikë e referuar si multitasking media. Ky multitasking mund të përfshijë shikimin e televizorit dhe përdorimin e një kompjuterit në të njëjtën kohë ose të qëndruarit në internet dhe angazhimin në më shumë se një aktivitet (Brasel SA, Gips J. 2011). Multitasking është term i njohur dhe i përhapur shumë në kohën e fundit sepse nga dita në ditë adoleshentët angazhohen në më shumë se një formë të mediave. Studimet kërkimore si (Moreno MA, Gannon KE, 2013) të cilët sugjerojnë në raporte të ndryshme se ka përfitime rreth përdorimit të mediave për fëmijët dhe adoleshentët e sotëm, të theksojmë komunikimin dhe angazhimin. Përfitimet përfshijnë ekspozimin ndaj ideve të reja, përvojat e të mësuarit dhe shumë të tjera. Shumë platforma të mediave sociale ofrojnë mjete që studentët mund t'i përdorin për të prekur bazën dhe për të bashkëpunuar me të tjerët në projekte të ndryshme. Komunikimi në distancë bëhet më i lehtë nga mediat sociale. Këto komunikime mund të përfshijnë lidhjen nëpërmjet video-bisedave me familjen ose miqtë që janë të ndarë gjeografikisht (Moreno MA, Gannon KE, 2013).

Prindërit dhe kujdestarët luajnë një rol të rëndësishëm në modelimin e sjelljeve optimale për fëmijët e tyre në përgjithësi, duke përfshi edhe kur bëhet fjalë për konsumin dhe përdorimin e mediave. Rritja e mediave dixhitale dhe sociale, veçanërisht në 5 vitet e fundit, ka parë rritje dramatike në përdorimin e mediave sociale nga të rriturit si dhe përdorimin nga fëmijët dhe adoleshentët; më shumë se 70% e të rriturve tani përdorin mediat sociale (Brenner J, Smith A., 2013).

1.3. Qëllimi i punimit

- ✓ Qëllimi kryesor i hulumtimit tonë është të përpiqemi të arrijmë një kuptim më të thellë të aktivitetit online të fëmijëve.
- ✓ Evidentimi i menyrave për kontroll mbi aktivitetin online.
- ✓ Mënyrën se si të rinjtë dhe prindërit menaxhojnë dhe përjetojnë rreziqe dhe sfida në lidhje me përdorimin e internetit dhe videolojrave.
- ✓ Cilat janë ndryshimet ose ngjashmëritë midis fëmijëve dhe prindërve në aktivitetet e tyre në internet, perceptimin e internetit ose videolojrave dhe menaxhimin e rreziqeve .
- ✓ Cilat sfida dhe rreziqe në internet janë më shpesh të hasura nga të rinjtë.
- ✓ Si reagojnë, menaxhojnë dhe përballen të rinjtë me rreziqet dhe sfidat në internet dhe nëse ka ndonjë program ose mjet për të monitoruar dhe kontrolluar marrëdhëniet mes përdorimit të internetit ose video lojërave dhe rrezikun potencial që ata e posedojnë.
- ✓ Vetëdijësimi i popullatës me rreziqet të cilat i paraqet interneti me theks të veçantë tek fëmijët.

1.4. Hipotezat e hulumtimit

Duke u mbështetur në literaturën e shqyrtuar lidhur me menaxhimin prindëror mbi përdorimin e TIK-ut nga fëmijët e tyre, ngritëm katër hipotezat në vijim, pasi kishim dilema mbi nivelin që kanë prindërit për përfshirjen e fëmijëve të tyre në botën virtuale dhe rolin që ata luajnë në këtë proces në familjet e komunës së Strugës.


H1: Prindërit kanë nivel të ulët të informacionit për përfshirjen e fëmijëve në përdorimin e TIK-ut.

H2: Kontrolli dhe menaxhimi i përfshirjes së fëmijëve në botën virtuale nga ana e prindërve është i ulët.

H3: Niveli arsimor i prindërve ka korelacion pozitiv në lidhje me shpeshtësinë e përdorimit të internetit nga fëmijët.

H4: Niveli arsimor i prindërve ka korelacion pozitiv në lidhje me kontrollin e ushtruar nga prindi mbi aktivitetet on-line të fëmijëve të tyre.

KAPITULLI I DYTË



Literature Review

2. Shqyrtimi i literaturës për fëmijët në botën virtuale

2.1. Fillesat e internetit

Interneti ka lindur në epokën e Luftës së Ftohtë të 1960-së, si një rrjet i decentralizuar, i projektuar për të lejuar komunikimin dhe mbajtjen e rendit dhe kontrollit pas një lufte bërthamore (Ellerman, viti 2007). Pentagoni nuk donte që të humbiste të gjithë aftësinë e komunikimit të kompjuterave në rastin e shpërthimit të një bombe atomike. Për pasojë ekspertët e mbrojtjes së kompjuterave e decentralizuan të gjithë sistemin, duke krijuar një sistem të shumëfishtë lidhjeje për rrjetet e kompjuterëve. Në vitin 1969, katër universitete në SHBA-në perëndimore u lidhën me Departamentin e Mbrojtjes në Amerikë në një rrjet-të quajtur ARPANET (Research Avancuar Agjencia Project), dhe kjo nuk ndodhi shumë kohë përpara se studiuesit të fillonin të zhvillonin komunikimin personal në internet. World Wide Web (WWW) u lançua në vitin 1989, duke siguruar standardet që lejonin rrjetet e kompjuterave lokal të lidheshin me njëri-tjetrin dhe ta bënin më të lehtë për përdoruesit për

të zgjidhur rritjen e masës së informacionit online në dispozicion. Në veçanti, zhvillimi i gjuhës HyperText (lejoj interlinking e vendeve) dhe motorët e kërkimit hapën rrugën për krijimin e faqeve të internetit nga grupet, bizneset dhe individët që kërkonin të komunikonin me publikun e gjerë (Norris, 2001). Faqet e rrjeteve të para sociale u shfaqën në fund të viteve 1990. Faqja e parë e cituar si rrjet social është “SixDegrees”(Boyd & Ellison, 2007). Si një koncept novel “SixDegrees” nuk ishte e zbatueshme në drejtimin komercial. Faqja e parë që arriti popullaritetin masiv ishte “Friendster”, prezantuar në vitin 2002. Facebook nisi në shkurt të vitit 2004 nga Mark Zuckerberg si një rrjet social kolegji dhe ka arritur të jetë faqja më popullore ndër të gjitha rrjetet sociale. Interneti tani është mbi katër dekada i vjetër.

Në vitin 1965, Lawrence Roberts bëri dy kompjutera të ndarë në vende të ndryshme 'flasin' me njëri-tjetrin për herë të parë. Kjo lidhje eksperimentale përdori një linjë telefonike me një modem të çiftuar akustikisht, dhe transferoi të dhënat dixhitale duke përdorur paketa(Science Media Medium).

Midis viteve 1986 dhe 1987, rrjeti i internetit u rrit nga 2,000 mikpritës në 30,000. Njerëzit filluan ta përdornin internetin për t'i dërguar mesazhe njëri-tjetrit, për të lexuar lajme dhe për të shkëmbyer informacione.

Tim Berners-Lee ishte i pari që krijoi një pjesë të softuerit që mund të paraqiste dokumente HTML në një format më të lehtë për t'u lexuar. Ai e quajti këtë 'shfletues' 'WorldWideWeb'. Megjithatë, ky aplikim origjinal kishte përdorim të kufizuar pasi mund të përdoret vetëm në makinat e avancuara NeXT. Një version i thjeshtuar që mund të funksiononte në çdo kompjuter u krijua nga Nicola Pellow, një student i matematikës, i cili punonte së bashku me Berners-Lee në CERN(Tim Berners-Lee (1998).

Interneti ka revolucionarizuar botën e kompjuterëve dhe komunikimit si asnjëherë më parë. Shpikja e telegrafit, telefonit, radios dhe kompjuterit, përgatiti terrenin për këtë integrim të paparë të aftësive. Interneti në të njëjtën kohë përbën aftësinë e transmetimit mbarëbotëror, një mekanizëm për përhapjen e informacionit dhe një medium për bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis individëve dhe kompjuterave të tyre pa marrë parasysh vendndodhjen gjeografike(P. Baran,1964).

Brezi i sotëm i fëmijëve dhe adoleshentëve është i rrethuar dhe i zhytur në një mjedis dixhital. Mediat tradicionale, si televizioni dhe radioja, janë plotësuar nga teknologjitë e reja dixhitale që nxisin angazhimin interaktiv dhe social dhe u lejojnë fëmijëve dhe adoleshentëve qasje të menjëhershme në argëtim, informacion, njohuri, kontakt shoqëror; dhe marketing.(Yolanda Reid Chassiakos, Jenny Radesky, Dimitri Christakis, Megan A. Moreno, Corinn Cross 2016) .

Një përkufizim për internetin është ai i wikipedias, i cili e përshkruan internetin si një sistem global të rrjeteve të ndërlidhura kompjuterike që përdorin standarde protokolli të plota të internetit (TCP/IP) për t'iu shërbyer disa miliarda përdoruesve në mbarë botën. Ky është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona biznese private, publike, akademike, rrjete qeveritare, të fushës lokale dhe globale, që janë të lidhura me një rrjet të gjerë të teknologjive elektronike, pa tel dhe rrjeteve optike. Interneti mbart një gamë të gjerë të burimeve dhe shërbimeve të informacionit, të tilla si dokumentet e ndër-lidhura HyperText e World Wide Web (WWW), infrastruktura për të mbështetur email, dhe rrjetet e peer-to-peer.




Figura 1: Përdoruesit e internetit për 100 banorë në botë

2.2. Teknologjia dhe zhvillimi i fëmijëve në botën virtuale

Në dekadën e fundit ndikimi i teknologjisë është bërë i pashmangshëm. Shpejtësia e përhapjes së tij e ka bërë pjesë të pandarë të jetës së adoleshentëve. Teknologjitë e reja, jo vetëm që janë bërë një mjet i rëndësishëm që lidhin adoleshentët me shokët e tyre (Subrahmanyam & Greenfield, 2008), por ndikimi i tyre po reflektohet në mënyrën e zhvillimit dhe të sjelljes në adoleshencë. Në fakt, (Greenfield dhe Yan 2006) i referohen internetit si një mjet kulturor, i përbërë nga një seri e pafundme aplikacionesh. Mjediset online janë hapësira kulturore, ku normat janë krijuar në mënyrë të përbashkët dhe janë transmetuar tek përdoruesit. Kultura online nuk është statike, por është një entitet dinamik ciklik, dhe përdoruesit janë vazhdimisht në gjenerimin, duke kaluar në norma të reja. Në vitin (1904) Stanley Hall e karakterizoi adoleshencën si “stuhë dhe stres” dhe ky karakterizim u bë shumë popullor. Adoloshenca është një periudhë zhvillimi që gjendet midis fëmijërisë dhe moshës madhore, është një periudhë e ndryshimeve të mëdha në aspektin biologjik, psikologjik dhe social. Për nga ky këndvështrim, ndikimi i botës virtuale është kthyer në objektin më të madh të diskutimit, sepse disa e shohin ndikimin e tij si kërcënim apo pengesë për këtë periudhë tranzicioni. Teknologjitë e reja kanë sjellë një formë të re të ndërveprimit social në botën dixhitale dhe mes adoleshentëve, komunikimi me bashkëmoshatarët është një nga përdorimet më të popullarizuara të teknologjisë (Subrahmanyam & Greenfield, 2008).

Ndarja dixhitale është dallimi midis grupeve me qasje të teknologjive dhe internetit dhe atyre pa qasje. Në vitin 2001 Norris. P arriti të vërtetojë se vajzat dhe gratë kanë më pak akses në teknologji dhe internet krahasuar me djemtë dhe burrat. Veçanërisht në vendet në zhvillim, vajzat dhe gratë luftojnë për të përballuar teknologjinë dhe aksesin në internet. Përveç kësaj, stereotipet rreth teknologjisë janë 'për djemtë' dhe frika se mos diskriminohen i ndalojnë vajzat të përdorin mjete dixhitale (Norris. P, 2001)

Në një studim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili zgjati nga viti (2001 deri 2012) u vërtetua se kemi një ulje të madhe të vazhdueshme e statistikore të përdorimit të televizionit dhe se përdorimi i internetit dhe rrjeteve sociale nga adoleshentët rritet shpejt nga dita në (John Wiley & Sons Ltd. 2015)

Aktivitetet online mund të zëvendësojnë aktivitete të tjera të rëndësishme që në mënyrë indirekte ndikojnë në mirëqenien e individit, adoleshentit. Një aspekt i rëndësishëm

për t'u marrë në konsideratë është zvogëlimi i orëve të gjumit. Krahasuar me vitet 1974 dhe 1993 adoleshentët bien më vonë të flenë. Koha e zgjimit nga gjumi nuk ka ndryshuar duke sjellë si pasojë një zvogëlim total të kohës së gjumit (Iglowstein, Jenni, Molinari&Largo, 2003).

Adoleshentët janë më të prekshëm se grupmoshat e tjera për të përdorur të tepruar, duke qenë se nuk janë të zhvilluar plotësisht në aspektin fizik dhe atë intelektual (Van den Eijnden RJ, Meerkerk GJ, Vermulst AA, Spijkerman R, Engels RC.2016).

Hulumtimet tregojnë se Interneti prek adoleshentët në katër fusha: shëndetin fizik, zhvillimin psiko-social, performancën akademike dhe marrëdhëniet familjare (Clark DJ, Frith KH, Demi AS, 2004).

Egzistojnë teori të ndryshme, të cilat shpjegojnë ndikimin e teknologjive në zhvillimin e adoleshentëve në botën virtuale, më poshtë do t'ju paraqesim disa nga to.

Në vijim të teorisë "The ecological systems theory" u modelua një perspektivë ekologjike e ndikimit të medias në zhvillimin e fëmijëve. Konceptualizimi i ekologjisë në zhvillimin njerëzor përshkruan natyrën dhe gamën e ndikimeve që ka përdorimi i mediave te të rinjtë. Nga kjo perspektivë ekologjike, të rinjtë janë parë si subjekt i forcave kontekstuale, duke fituar nga ndikimet e proceseve, në të cilat ata operojnë në rrathët e tyre të përditshëm tek rrathët më skajorë. E rëndësishme, nga një perspektivë ekologjike, është fakti se mjediset nuk janë ente, por reflektime të proceseve të ndikimit. Ata që e përkrahin këtë teori e shohin median dhe efektet e saj si faktor të jashtëm dhe me efekte të jashtëm për përdoruesit. Edhe pse nuk thuhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, efekti i mediave e sheh përdoruesin si një marrës pasiv të efektit mediatik.




Figura 2: Teoria e sistemeve ekologjike

Uses and Gratification theory (UGT) of mass media (Blumler & Katz, 1974), sugjeroi se njerëz të ndryshëm e përdorin median për qëllime të ndryshme ose kënaqësi të tilla si arratisja, informacioni, dhe argëtimi. Kjo teori theksoi se, përdoruesit e medias kanë një rol aktiv si në zgjedhjen e tyre dhe rrjedhimisht edhe në efektet që media mund të ketë mbi ta. Evolucionin në përdorimin e kësaj teorie e ka ruajtur qëndrimin edhe me zhvillimin e teknologjive të reja të komunikimit.



Figura 3: Përdorimet dhe teoria e kënaqësisë (UGT)

2.3. Strategjitë prindërore për ndërmjetësim

Shtëpia është vendi ku adoleshentët e përdorin më së shumti internetin. Prindërit janë ata të cilët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kujdesin dhe ruajtjen e fëmijëve të tyre. Suksesi i punës së tyre varet nga një sërë faktorësh, të cilët lidhen me informacionin që ata kanë për aktivitete që fëmijët kryejnë online, çfarë shohin fëmijët dhe çfarë bëjnë ata në hapësirat e ofruara nga bota virtuale. Ndërhyrja teknologjike i referohet përdorimit të strategjive teknologjike nga ana e prindërve për të filtruar përdorimin e internetit nga fëmijët. Prindërit mund të instalojnë programe të ndryshme në mënyrë që të kufizojnë ekspozimin e dhunshëm dhe potencialisht shqetësues të fëmijëve në internet. Një model i sygjyer nga (Eastin, M.S., Greenberg, B. S., & Hofschire, L. (2006) i cili sugjeroi:

- FOL- BESIM
- VLERËSIM
- MËSIM
- KOMUNIKIM

- **FOL- BESIM** : Besimi është kritik për prindërit, veçanërisht tani në kohën e internetit. Nuk është e vështirë të shohësh se çfarë shohin fëmijët në internet, por ajo që sugjerohet është të flasësh me fëmijën për të kuptuar se çfarë ai/ajo bën kur qëndron on-line. Bashkëpunimi i hapur sjell besimin
- **VLERSIMI** : Jo gjithmonë prindërit dinë se çfarë bëjnë fëmijët e tyre në internet. Këtë mund ta mësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe të tërthortë. Veprimi që sugjerohet në këtë rast është shpenzimi i kohës me fëmijën on-line, duke e pyetur fëmijën që t’iu tregojë se çfarë komentesh, fotosh dhe materialesh të tjera ai/ajo sheh dhe poston në internet, për të kuptuar se si fëmijët e prezantojnë veten e tyre on-line.
- **MËSIMI**: Nëse nuk dini si të bëheni pjesë e internetit pyetni fëmijën tuaj. Dr Justin Patchin thekson: “Ne i inkurajojmë prindërit të ulen dhe me fëmijët të punojnë në internet. Adoleshentët mund t’i mësojnë prindërit për teknologjitë dhe prindërit mund t’i mësojnë ata për të bërë zgjedhje të përgjegjshme on-line”.
- **KOMUNIKIM**: Komunikimi i prindërve me fëmijët e tyre është mjaft i rëndësishëm. Ai është çelësi i suksesit.




Figura 4: Zhvillimi i adoleshentëve në mjedisin e sotshëm

Studiuesit nga fusha të ndryshme, përfshi psikologjinë, shkencat shoqërore, kujdesin shëndetësor dhe arsimin, po studiojnë faktorët e lidhur që ndikojnë në përhapjen e varësisë nga interneti (IA, Internet Addiction). Midis këtyre studimeve, një faktor i identifikuar i lidhur me përdorimin e internetit që ndikon në sjelljen e adoleshentëve është prindërimi.

Sipas Miller dhe Plant, shkalla e prindërimit lidhet fort me sjelljen e adoleshentëve. Është e qartë se udhëzimi dhe monitorimi i prindërve e zvogëlon ndikimin e reklamave të alkoolit tek adoleshentët, duke zvogëluar kështu konsumin e tyre. Studime të tjera dëshmojnë se prindërit veprojnë si modele pozitive dhe e mbrojnë fëmijët e tyre adoleshentë nga varësia e Internetit (IA) (Miller P, Plant M, 2010)

Familja ka një rol të rëndësishëm në ndikimin në jetën e adoleshentëve. Është treguar se familja është një faktor mbrojtës në parandalimin e adoleshentëve nga pjesëmarrja në sjellje problematike dhe të rrezikshme, për shembull, përdorimi i duhanit, substancave të paligjshme dhe alkoolit (Miller P, Plant M, 2010).

Në vitin 1984 Patterson GR, Stouthamer-loeber M diskutoi disa lloje të qasjeve të prindërimit. Theks të veçantë i venduan monitorimit prindëror, stilit të prindërimit dhe udhëzimit prindëror.

Monitorimi prindëror nënkupton mbikëqyrjen e jetës së përditshme të një adoleshenti. Stili prindëror fokusohet në klimën e përgjithshme të prindërimit në shtëpi ndërsa udhëzimi prindëror është më specifik për një lloj aktiviteti. Udhëzimi prindëror i referohet vendosjes së rregullave, dhënies së drejtimit, këshillimit, bërjes së një dallimi të qartë midis së drejtës dhe të gabuarës dhe sigurimit të mbrojtjes në aktivitetet e përditshme (Patterson GR, Stouthamer-loeber M, 1984).

Si konkluzion mund të themi se prindërit mund të mos i shoqërojnë adoleshentët gjatë gjithë kohës, por në vend të kësaj mund t'u japin këshilla adoleshentëve para se të lundrojnë në internet rreth rreziqeve potenciale dhe informatave të rrejshme, të cilat ekzistojnë në botën virtuale për anashkalimin e efekteve potencialë tek adoleshentët.

2.4. Kuadri ligjor rregullator për komunikimin virtual

Ky kapitull fokusohet në pasqyrimin dhe analizimin e kontekstit ndërkombëtar dhe atij kombëtar të legjislacionit dhe politikave për të siguruar shërbime të sigurta në mbrojtje të

fëmijëve dhe të interesit të tyre më të lartë. Kuadri ligjor është i një rëndësie specifike kur bëhet fjalë për interesin më të lartë të adoleshetëve

2.4.1. Akte të OKB-SË:

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, (1948), sipas kësaj deklarate fëmijët, si kategori e veçantë gëzojnë mbrojtje të veçantë. Në përputhje me statusin e ndjeshëm dhe jo shumë të fuqishëm që kanë fëmijët në shoqëri DUDNJ, Kombet e Bashkuara ritheksuan faktin se “mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë” kjo deklaratë ka për qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal të të drejtave. CEDAW-Konventa për Eliminimin e Çdo diskriminimi ndaj grave synon një mbrojtje direkte të të drejtave të grave dhe mbrojtje të tërthortë për të drejtat e fëmijëve.

2.4.2. Akte të Këshillit të Evropës

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e nënshkruar nga qeveritë anëtare të Këshillit të Evropës, në kuadrin e mbrojtjes dhe zhvillimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij, në nenin 1 të saj thekson: “Detyrimin e shteteve për t’i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut”. Karta Evropiane Sociale e miratuar me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002, parashikon se fëmijët dhe adoleshentët kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë kundër rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilëve ekspozohen.

2.4.3. Përkufizime shtesë

- **Interneti:** - Është rrjet kompjuterik, i cili përbëhet nga qindra mijë rrjete kompjuterike, të madhësive të ndryshme, të cilat janë lidhur dhe kanë shtrirje gati në të gjithë rruzullin tokësor, nëpërmjet të cilëve mundësohen një sërë shërbimesh përfshi komunikimin, zbavitjen, informimin etj
- **Adoleshentët:** - Janë persona të cilët i përkasin fazes së jetës midis fëmijërisë dhe moshës së pjekurisë.

- **Rrjet social:** - Faqe interneti që lejojnë përdoruesit për të krijuar një profil të personalizuar brenda një sistemi. Faqet e profilit të personalizuar mund të përfshijnë të dhëna demografike, arsimore, informacione e kontakte, revista (blogs), muzikë dhe video, links, albume me foto, mesazhe. Ato të japin mundësinë të krijosh një rrjet me përdorues dhe miq për të bashkëvepruar.
- **Web:** - është një term që emërton internetin e zhvilluar dhe mënyrat e reja interaktive, me të cilat njerëzit e përdorin atë.
- **Bota virtuale:** - Përfshin përdorimin e telefonit celular dhe kompjuterit për të luajtur lojëra online, për të lundruar në internet dhe rrjete sociale.
- **Videolojrat:** - Ky term përfshin çdo gjë, duke nisur nga luajtja e një loje të thjeshtë, deri tek lojërat masive me më shumë lojtarë.

KAPITULLI I TRETË



3. Metodologjia e hulumtimit

Ky është një studim aktual-bashkëkohor, i cili, me anë të metodës sasiore të grumbullimit të të dhënave, përshkruan dhe analizon përdorimin e internetit dhe të rrjeteve sociale nga adoleshentët dhe ndikimin që ato kanë në sjelljen e këtyre të fundit. Qëllimi i këtij studimi është të kuptuarit e sjelljes dhe përfshirjes të adoleshenentëve në botën virtuale . Mungesa e studimeve të mëparshme në këtë fushë rekomandon nga ana tjetër aplikimin e një metodologjie përgjithësuese. Përdorimi i saj na ndihmon të shpjegojmë ndikimin e botës virtuale në sjelljen e adoleshentëve, duke u bazuar edhe në karakteristikat që paraqet kjo grup-moshë, si një nga sfidat më të rëndësishme jo vetëm për ta, por njëkohësisht për prindërit, familjen, shkollën dhe komunitetin në përgjithësi. Nëse në këtë periudhë tranzicioni do t'iu ofronim adoleshentëve mbështetjen e duhur sociale, për adoleshentët do të krijohet mundësia e një përshtatjeje të suksesshme (Pratt et al., 2000). Metodologjia e këtij studimi përfshin edhe një komponent cilësor, i cili konsiston në intervista, pyetësor direkt dhe

nëpërjet emailit në mënyrë indirekte. Gjatë hulumtimit kemi përdorur programe të posaçme për analizat e të dhënave si Microsoft Excel, SPSS dhe One-Sample Test.

3.1. Popullata e studimit

Përdorimi i internetit në vitet e fundit shpreh një dinamikë rritjeje shumë të shpejtë në të gjithë vendin nga të gjithë grup moshat. Nga ana tjetër adoleshentët janë në mes të përdoruesve më të zellshëm të kësaj teknologjie. Popullata e studimit përfshin adoleshentët, përfshirjen e tyre në botën virtuale, informacionet e prindërve rreth përfshirjes të adoleshentëve në botën virtuale, përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK), ndikimi i botës virtuale në jetën e adoleshentëve, dhe moshën në të cilën kyqen adoleshentët në botën virtuale. Target grupi përfshin prindërit të cilët kanë fëmijë adoleshentë. Rezultatet e pyetsorëve do të paraqiten nëpërmjet grafikoneve në vijim.

3.2. Instrumentet e kërkimit

Grumbullimi i të dhënave u realizua në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të pyetsorëve si dhe në formë indirekte nëpërmjet “Google Forms”.

3.3 Etika

Të gjithë të anketuarit u kyçën në studim pasi u informuan për qëllimin e studimit, për privatësinë, duke i siguruar se pyetësi do të ishte anonim dhe se të dhënat e grumbulluara prej tyre nuk do të ishin të identifikueshme. Të gjithë pjesëmarrësit e dhanë pëlqimin verbal për të marrë pjesë para mbledhjes së të dhënave.

3.4. Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave

Të dhënat janë futur në Excel për t’u kalkuluar më pas nga to frekuenca e përgjigjeve, përqindjet e përfituara nga përgjigjet si dhe paraqitja e të dhënave të grumbulluara nga

studimi me grafikone. Janë përpunuar në mënyrë statistikore nga Microsoft Excel Version 2016 dhe SPSS- Statistical Package for the Social Sciences. Analizimi i të dhënave të grumbulluara do të kryhet nëpërmjet një statistike të hollësishme përshkruese, One-Sample Test dhe korrelacioni, të cilat do të shfaqen gjatë punimit në vijim. Gjithashtu në bazë të analizave të kryera, do të arrihet konkluzioni rreth hipotezave të parashtruara më lart.

KAPITULLI I KATËRT




4. Rezultatet e hulumtimit

4.1. Të dhënat socio-demografike


Pas grumbullimit të të dhënave, të dhënat ju nënshtuan një kontrolli dhe filtrimi në programin Microsoft Excel dhe programit statistikor SPSS, ku një numër i vogël i të anketuarëve u morën si të pavlefshme, si rezultat i asaj që ishin të pakompletuara. Më pas u përpunuan të dhënat dhe fituam rezultatet e mëposhëme.

Nga të dhënat socio-demografike do të shqyrtohen këto të dhëna të anketuarëve: niveli i shkollimit të prindërve, gjinia e prindërve pjesëmarrës në studim, përqindja e prindërve të punësuar si dhe gjinia e fëmijës.




Grafiku 1: Shkollimi i prindërve

Si pjesë e të dhënave socio-demografike është analizuar shkollimi i prindërve të anketuar dhe siç shihet nga rezultatet e arritura, vërehet se shumica e prindërve kanë shkollim të lartë, e përfaqësuar me 61.68%; 1.63% e prindërve të anketuar kanë Magjistraturë, 16.82% e tyre kanë shkollim të mesëm dhe vetëm 1.87% e të anketuarve kanë Doktoratë (Grafiku 1).




Grafiku 2: Gjinia e të anketuarve

Sipas rezultateve të arritura nga studimi ynë, u vërejt se 60.7% e prindërve të anketuar ishin të gjinisë mashkullore ndërsa, 39.3% e tyre janë të gjinisë femërore.



Grafiku 3. Punësimi i të anketuarëve

Në pyetjen a janë të punësuar prindërit e anketuar, arritëm në këto rezultate: 88,8% e tyre janë të punësuar ndërsa 11.2% e prindërve nuk janë në marrëdhënie pune .




Grafiku 4: Gjinia e fëmijës

Sa i përket gjinisë së fëmijës, rezultatet e arritura ,: 55.1% e fëmijëve janë të gjinisë mashkullore ndërsa, 44.9% e fëmijëve të gjinisë femërore.


4.2. Informacioni i prindërve rreth përfshirjes së fëmijëve në botën virtuale

Në këtë studim morën pjesë N: 214 prindër, të cilët u përgjigjën që 196 prej fëmijëve të tyre janë përdorues aktiv të internetit ndërsa 18 prej tyre nuk e përdorin internetin.



Grafiku 5: Niveli i përfshirjes së adoleshentëve në botën virtuale


Në pyetjen 'A ka fëmija juaj një telefon celular' doli se 95.3% e fëmijëve posedojnë telefon celular personal, kundrejt 4.7% që nuk posedojnë.



Grafiku 6. Posedimi i telefonit celular tek fëmijët

Në pyetjen ‘A është fëmija juaj anëtar i ndonjë rrjeti social’, 72.0% janë anëtarë të ndonjë rrjeti social , 26.2% u përgjigjen jo ndërsa 1.9% nga to nuk e di.

Nga grafiku 7 shohim një përfshirje të madhe të fëmijëve në rrjetet sociale, gjë e cila paraqet rrezik nëse nuk kontrollohen nga ana e prindërve por edhe përdormi i softverteve parandaluese të rrëziqueve potencialë, të cilat mund të hasen në aktivitetin online.




Grafiku 7. Posedimi i rrjeteve sociale nga ana e adoleshentëve


Në pyetjen “A keni informacion sa shpesh e përdor fëmija juaj internetin?” 93.9% e prindërve janë ne dijeni për përdorimin e internetit nga ana e fëmijëve të tyre ndërsa 6.1% nga to nuk janë ne dijeni rreth kësaj pyetjeje.

Me anë të këtij grafikoni arrijmë të dëshmojmë se hipoteza e parë nuk vertetohet, sepse kemi një nivel të lartë të prindërve, të cilët janë në informim e sipër për përfshirjen e fëmijëve të tyre në internet.

Të dhënat mbi përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) nga ana e prindërve; shpeshësia e përdorimit të internetit mbrenda ditës dhe javës nga adoleshentët do të paraqitet në grafikonet 8 dhe 9.




Grafiku 8. Njohuria e prindërve në lidhje me shpeshtësinë e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës




Grafiku 9. Përdorimi i TIK nga prindërit

Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) është pothuajse jo egzistues nga ana e prindërve për shkak se shumica nuk janë të informuar për ekzistimin e softuerve të posaçëm për kontroll dhe filtrim të të dhënave, të cilat adoleshenët mund t'i shohin ose lexojnë në internet . Pjesa dërmuese (98%) nuk janë përdorues ndërsa vetëm 2% janë përdorues të teknologjive të informacionit dhe informimit. Kjo gjithashtu paraqet një menaxhim të dobët nga ana e prindërve me rrëziqet dhe sfidat potenciale, të cilat mund të shfaqen nga dita në ditë në aktivitetin online të fëmijëve.



Grafiku 10. Shpeshtësia e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës brenda ditës

Nga 93.9% e prindërve që u deklaruan se fëmijët e tyre e përdorin internetin, 86.0 % e të anketuarëve u përgjigjen se fëmijët e tyre e përdorin internetin disa herë brenda ditës , ndërsa 14.0% prej tyre thanë se e përdorin një herë ne ditë.




Grafiku 11. Shpeshtësia e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës brenda javës

93.9% e të anketuarve u përgjigjën se gjatë javës, fëmijët e tyre janë përdorues të internetit 3-5 ditë në javë ndërsa 6.1% e përdorin 1-2 ditë në javë.

Në grafikonet 10 dhe 11 shohim një përfshirje të madhe të adoleshentëve në botën virtuale. Mbase kjo përfshirje e madhe e adoleshentëve në botën virtuale është në një përqindje shumë të madhe, duhet konsideruar mjetet për menaxhim të informacioneve, të cilat ata i konsumojnë, informata të cilat mund të shkaktojnë ndryshime në sjelljen dhe vendimet e tyre në botën reale. Menaxhimi i këtyre të dhënave është me rëndësi, prandaj duhet kushtuar kujdes të veçantë TIK-ut dhe softverteve të cilat filtrojnë informacionet të cilat shfaqen në përditshmërinë e aktivitetit online të adoleshentëve.

4.3. Mosha e fillimit të përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale nga fëmijët


Mosha e fillimit të përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale nga fëmijët, shfaqet në moshë shumë të re. Shumica e tyre fillojnë ndërmjet moshës (8-10 vjet) të jenë antarë të rrjeteve sociale ndërsa përdorimin e internetit në moshë edhe më të re. Të dhënat e grumbulluara do t'i shfaqim në grafikun në vijim.



Grafiku 12. Mosha e fëmijës që përdor internetin

4.4. Koha e shpenzuar nga fëmijët në internet dhe rrjete sociale (në ditë)

Kjo është një ndër problematikat më të theksuara, me të cilën hasen prindërit nga dita në ditë ngase koha që adoleshentët e shpenzojnë në rrjetet sociale , internet dhe telefonat celularë përfshin një pjesë të madhe të ditës së tyre. Të dhënat do të shfaqen në grafikun në vijim.




Grafiku 14. Orët e harxhuara në internet nga fëmijët

Nga grafiku i shfaqur më lart hasim një mesatare të lartë të shpenzimit të kohës së fëmijëve në internet, telefon dhe kompjuter mbrenda ditës. Menaxhimi me kohën dhe informatat me të cilat mund të shfaqen gjatë aktivitetit online paraqet shqetësim për prindërit.

4.5. Njohuritë mbi kontrollet prindore dhe efektet që shkakton bota virtuale tek fëmijët


Në formimin e personalitetit të adoleshentit ka një ndikim të madh shoqëria dhe mënyra e komunikimit. Vetë personaliteti është rezultat i komunikimit njerëzor, sepse ndikimi shumëformësh nuk mund të realizohet jashtë procesit të komunikimit. Bota virtuale ka mundur një larmi formash të reja komunikimi, të cilat po përhapen në një mënyrë të shpejtë, veçanërisht tek adoleshentët. Fakti që adoleshentët janë të përfshirë në masë shumë

të madhe në botën virtuale, paraqet shqetësim edhe për prindërit, të cilët kanë shfaqur shqetësimin e tyre, të cilin do ta paraqesim në grafikonin e radhës, ku 91.6% janë shumë të shqetësuar.




Grafiku 15. Shqetësimi i prindërve për karakterin e informatave që mund të hasen nga fëmijët në internet

Nga grafikoni me lart mund të konkludojmë se të gjithë prindërit e anketuar shfaqin shqetësim të lartë rreth informacioneve, të cilat mund të lexojnë ose të shikojnë në internet.



Grafiku 16. Njohuria e prindërve në lidhje me ekzistimin e programeve të posaçëm për kontrollin e aktivitetit online

Nga grafikoni 16 më lart, arrijmë në konkluzion se kemi një pjesë të madhe të prindërve, të cilët nuk kanë informata që ekzistojnë programe të posaçme për kontrollin e aktivitetin online 67.3% . Kjo paraqet një problematikë të rradhës, e cila mund të zgjidhet duke i informuar prindërit se ekzistojnë programe të posaçme, të cilat kontrollojnë aktivitetin online. Këtu gjithashtu vlen të ceket rëndësia e TIK-ut, e cila e bën më të lehtë eksperiencën e prindërve sepse i informon dhe i mëson prindërit rreth rrëziqueve dhe sfidave me të cilat mund të hasen fëmijët e tyre në aktivitetet e tyre online, të cilat siç e vërtetuar më lart janë të shpeshta në baza ditore, javore dhe mujore.



Grafiku 17. Opinioni i prindërve në lidhje me ndikimin e internetit në sjelljen e fëmijës

Përfshirja e fëmijëve në botën virtuale rritet nga dita në ditë. Në të njëjtën kohë ajo paraqet sfidat dhe rrëziquet e saja. Në grafikun më lart, shohim se koha e shpenzuar në internet e fëmijëve ndikon në sjelljet e tyre të përditshme. Një përqindje e madhe e prindërve (72%) u përgjigjën se përfshirja online ndikon në sjelljen e fëmijëve të tyre në jetën e përditshme. Kjo siç e vërtetuar në grafikun 15, paraqet shqetësim të lartë tek prindërit.

4.6. Testimit i hipotezave

Më lart u diskutua mjaft në lidhje me pasqyrimin e nivelit të përfshirjes së adoleshentëve në realitetin virtual të komunës së Strugës, sipas disa karakteristikave mbi nivelin e informacionit që kanë prindërit për përfshirjen e adoleshentëve në botën virtuale dhe rolin që ata luajnë në këtë proces.

Për të analizuar nivelin e përfshirjes së adoleshentëve në realitetin virtual të komunës së Strugës, ne ngritëm katër hipoteza në fillim të punimit, ku në vazhdim do bëjmë vërtetimin e tyre.

Testimit i hipotezave është bërë përmes programit statistikor SPSS- Statistical Package for the Social Sciences të destinuar për këtë lloj hulumtimi, duke përdorur One-Sample Testin dhe korrelacionin.

H1: Prindërit kanë nivel të ulët të informacionit për përfshirjen e fëmijëve në përdorimin e TIK-ut.

Për ta vërtetuar këtë hipotezë, supozojmë se pjesa e prindërve që kanë njohuri në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të internetit nga ana e fëmijëve në komunën e Strugës është më e vogël se 75 %.

$$H_0: p \leq 0.75$$

$$H_a: p > 0.75$$

Duke i vendosur të dhënat në tabelën dialoguese të programit SPSS, me nivel të rëndësisë $\alpha=0.05$, del se statistika e testit T është $t_\alpha = -2977.15$ dhe p-vlera e llogaritur është 0.000. Meqë $p = 0.000 < 0.05$ dhe $t_\alpha = |-2977.15| > 1.645 = t_{0.05}$ (bishti i majt i shpërndarjes normale) hidhet poshtë hipoteza H_0 në favor të hipotezës H_a .

Pra, qëndron hipoteza H_a që një pjesë e prindërve që kanë njohuri në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të internetit nga ana e fëmijës në komunën e Strugës është më e madhe se 75 %. Intervali i besimit është $[-73.99, -73.89]$. Tabela 1.

One-Sample Test

	Test Value = 75					
	t	Df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Loëer	Upper
PerdorimiTIK	-2977.151	95	.000	-73.93750	-73.9868	-73.8882

Tabela 1: Rezultatet e hipotezës së parë

H2: Kontrolli dhe menaxhimi i përfshirjes së fëmijëve në botën virtuale nga ana e prindërve është i ulët.

Për ta vërtetuar këtë hipotezë, supozojmë se përpjesa e prindërve që kanë njohuri mbi ekzistencën e programeve të posaçme për kontrollin e aktiviteteve online tek fëmijët e tyre më i madh se 75 %

$$H_0: p \geq 0.75$$

$$H_a: p < 0.75$$

Duke i vendosur të dhënat në tabelën dialoguese të programit SPSS, me nivel të rëndësisë $\alpha=0.05$, del se statistika e testit T është $t_\alpha = -1516.25$ dhe p-vlera e llogaritur është 0.000. Meqë $p = 0.000 < 0.05$ dhe $t_\alpha = |-1516.25| > 1.645 = t_{0.05}$ (bishti i majt i shpërndarjes normale) hidhet poshtë hipoteza H_0 në favor të hipotezës H_a .

One-Sample Test

	Test Value = 75					
	T	Df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Loëer	Upper
Kontrolli prindor	-1516.245	95	.000	-73.33333	-73.4294	-73.2373

Tabela 2: Rezultatet e hipotezës së dytë

Pra, qëndron hipoteza H_a që përpjesa më e madhe e prindërve nuk kanë njohuri mbi ekzistencën e programeve të posaçme për kontrollin e aktiviteteve online tek fëmijët e tyre në Komunën e Strugës. Intervali i besimit është [-73.43, -73.24]. Tabela 2.

H3: Niveli arsimor i prindërve ka korelacion pozitiv në lidhje me shpeshtësinë e përdorimit të internetit nga fëmijët.

Siç mund të shohim se korelacioni në kolonën e parë, rendi i dytë është 0.89, që tregon një korelacion të fortë duke pasur parasysh se korelacioni lëviz prej 0-1 dhe, kjo është me afër 1. Vlera e p-së në kolonën e mëposhtme është .000 dhe lidhet me rezultatin paraprak, që tregon se vlera e p-së është më e vogël 0.05 apo 0.01, që me fjalë tjera do të thotë se për arsye që vlera e p është më e vogël se vlera e alphas, atëherë ajo është me rëndësi statistikore. Kjo do të thotë se ne mund ta pranojmë hipotezën se ekziston një lidhje e forte ndërmjet nivelit të njohurive të shpeshtësisë së përdorimit të internetit tek fëmijët dhe nivelit arsimor tek prindërit. Tabela 3.

Correlations

		PerdorimiTIK	Arsimimi i prindërit
PerdorimiTIK	Pearson Correlation	1	0.89*
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	214	214
Arsimimi i prindërit	Pearson Correlation	0.89*	1
	Sig. (2-tailed)		
	N	214	214

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Tabela 3: Rezultatet e hipotezës së tretë

H4: Niveli arsimor i prindërve ka korelacion pozitiv në lidhje me kontrollin e ushtruar nga prindi mbi aktivitetet on-line te fëmijëve të tyre.

Pra, korrelacioni është 0.69 dhe vlera e p-së është 0.00, që tregon një korelacion të fortë me një rëndësi statistikore.

Kjo do të thotë se ne mund ta pranojmë hipotezën se ekziston një lidhje e fortë ndërmjet kontrollit të ushtruar nga prindërit mbi aktivitetet on-line te fëmijët e tyre dhe nivelit arsimor tek prindërit. Tabela 4.


Correlations

		Kontrolli prindor	Arsimimi
Kontrolli prindor	Pearson Correlation	1	0.69*
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	214	214
Arsimimi	Pearson Correlation	0.069*	1
	Sig. (2-tailed)		
	N	214	214

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Tabela 4: Rezultatet e hipotezës së katërt

KAPITULLI I PESTË



5. Diskutime, konkluzione dhe rekomandime

5.1. Diskutime

Pjesë e studimit tonë ishin 107 prindër, të cilët janë pyetur në lidhje me aktivitetin e fëmijëve tyre në internet, ndjesitë dhe veprimet e prindërve në lidhje me këtë si dhe besimi dhe perceptimi i prindërve për efektet e internetit te të rinjtë.

Sipas studimit tonë, rezultoi se pjesa më e madhe e adoleshentëve pra, 92% e tyre janë përdorues të internetit ndërsa, vetëm 8% e tyre nuk kanë qasje në internet. Kjo u bazua në të dhënat e marra nga pikëpamja e prindërve. Sipas një studimi të realizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rreth 88 % e adoleshentëve të moshës midis 13 dhe 17 vjeç kanë qasje në internet nga një kompjuter ose laptop. Kjo ka të bëjë edhe me përkatësinë etnike dhe të ardhurat e familjes. Ndërsa 90 % e adoleshentëve të bardhë, jo-Spanjollë kanë qasje në kompjuter në vitin 2018, rreth 89 % e adoleshentëve të zinj, jo-Spanjollë kishin akses në një kompjuter në po të njejtin vit. Përafërsisht, rreth 97 % dhe 93 % e vajzave dhe djemve kanë

respektivisht qasje në një smartfon. Në përgjithësi, adoleshentët janë shumë të lidhur dhe i kryejnë shumicën e aktiviteteve në internet përmes celularit (*Joseph Johnson ,2021*). E njëjta gjë u vu në pah edhe nga studimi ynë.

Përdorimi i mediave sociale të fëmijëve është i larmishëm. Në bazë të një hulumtimi internacional të bazuar në Kroaci , Finlandë dhe Poloni tregohet se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve të moshës shkollore fillore kanë rrjete sociale të tyre, që do të thotë se kanë qasje në internet. Një e katërta e dhjetëvjeçarëve që kyçen në internet pretendojnë të kenë një profil të tyre dhe proporcioni pothuajse dyfishohet në 43% të 11-vjeçarëve. Deri në moshën 13 vjeç (kufizimi minimal i moshës në shumicën e platformave të mediave sociale) më shumë se gjysma kanë një profil; dhe në moshën 15 vjeç, pothuajse të gjithë kanë një të tillë (*Silvana Karacic.2017*).

Sipas një studimi tjetër, të realizuar në Taivan, u arrit në përfundimin se djemtë tajvanezë e përdorin internetin për t'u argëtuar, ndërsa vajzat tajvaneze kanë një pamje më praktike të internetit (*Tsai CC,2004*).

Nga hulumtimi ynë rezultoi se pjesa më e madhe e prindërve pohuan se fëmijët e tyre kanë përdorur internet nga mosha 8 vjeçare e përfaqësuar me 67% e totalit të të anketuarve. 22% e të anketuarve kanë treguar se fëmija e tyre ka qënë përdorues interneti prej moshës 9 vjeçare ndërsa 10% e prindërve kanë pohuar se fëmija e tyre ka përdorur internet prej moshës 10 vjeçare.

Shumica e prindërve të fëmijëve me një profil janë të vetëdijshëm se ekziston një kërkesë minimale për moshën për të pasur një profil. Sidoqoftë, relativisht pak e identifikojnë saktë moshën minimale për këto faqe ose aplikacione.

Facebook është më e njohura, me 27% të prindërve që e dinë kërkesën për moshën minimale, e ndjekur nga 20% për Instagram dhe 15% për Snapchat. Pothuajse gjysma e prindërve janë të vetëdijshëm se WhatsApp ka një kërkesë për moshën, por vetëm 5% janë të vetëdijshëm se 16 vjeç tani është mosha e kërkuar.

Një e katërta e prindërve të moshës 5-15 vjeç thanë se do të lejonin që fëmija i tyre të kishte një profil të mediave sociale para se ata të përmbushin kërkesën për moshën minimale

të lejuar për të kenë profile në rrjetet e ndryshme sociale. Kjo rritet me moshën e fëmijës, nga 8% e 3- 4 deri në 36% të 12-15 viteve-të pandryshuara që nga viti 2018.

Mediat online dhe qasja në internet kanë ndikime të shumta të adoleshentët goftë në aspekte pozitive apo negative. Prindërit pjesëmarrës në hulumtim, gjithashtu janë pyetur për opinionet e tyre në lidhje me ndikimin e internetit dhe mediave sociale në sjelljen e fëmijëve të tyre. Siç u vërejt nga rezultatet tona ,72% e prindërve mendojnë se interneti dhe mediat sociale ndikojnë në sjelljen e fëmijëve të tyre përkundër, 28% e tyre mendojnë se nuk ka ndikim. Nga një studim rasti mbi ndikimin e mediave sociale në sjelljen dhe ndjesinë e adoleshentëve, u vërejt se në përgjithësi, ato raportuan se ndiheshin më pak të vetmuar kur përdorin mediat sociale, ndërsa pos kësaj në krahasim 21 % gjithashtu raportuan se ndiheshin më të popullarizuar kur i përdorin platformat e mediave sociale. Sidoqoftë, përdorimi i mediave sociale nuk mund të ketë efekte pozitive vetëm tek adoleshentët: 70 % e adoleshentëve me mirëqenie të ulët social-emocionale raportuan se ndiheshin të lënë jashtë ose të përjashtuar kur përdorin mediat sociale, ndërsa në krahasim vetëm 29 % e adoleshentëve me mirëqenie të lartë shoqërore-emocionale e deklaruar në mënyrë të ngjashme.

Sipas nje studimi të realizuar nga Shoqata e Psikologëve Amerikanë vërehen këto të dhëna ku mes viteve 2006 deri 2016 është vërejtur rritja e ndjeshme e përdorimit të mediave dixhitale. Midis nxënësve të klasës së 12-të, përdorimi i internetit gjatë kohës së lirë u dyfishua nga një në dy orë në ditë gjatë asaj periudhe. Ai u rrit gjithashtu 75 % për nxënësit e klasës së 10-të dhe 68 % për nxënësit e klasës së tetë. Normat dhe rritjet e përdorimit ishin mjaft uniforme në gjini, racë/etni dhe status socio-ekonomik, sipas hulumtimit në fjalë. Në vitin 2010, mesatarja amerikane e klasës së 12-të raportoi se shpenzonte afërsisht dy orë në ditë duke shkruar mesazhe, pak më shumë se dy orë në ditë në internet-që përfshinte lojëra dhe pak më pak se dy orë në ditë në mediat sociale. Kjo është gjithësej rreth gjashtë orë në ditë në vetëm tre aktivitete të mediave dixhitale gjatë kohës së tyre të lirë . Përkundëjt kësaj në hulumtimin tonë vërejtëm se 94% e të anketuarve u përgjigjën se fëmijët e tyre e përdorin internetin disa herë ne ditë , ndërsa 6% prej tyre e përdorin një herë ne ditë. Këto të dhëna u arritën në bazë të shkallës Likert. Sa i përket përdorimit javor të internetit nga ana e fëmijëve, 94% e të anketuarëve u përgjigjën se gjatë javës fëmijët e tyre janë përdorues të internetit 3-

5 ditë në javë ndërsa 6% e tyre 1-2 ditë në javë. Sipas kësaj, vërehet një shifër mjaftë e madhe e fëmijëve të përfshirë në internet.

Shumë prindër ndihen të pasigurtë për veprimet dhe përvojat që fëmijët e tyre adoleshentë kanë në internet, duke shkaktuar kështu shqetësim. Sipas një studimi të realizuar në Suedi, qëllimi i të cilit ishte t'i shqyrtonte shqetësimet e prindërve në lidhje me përdorimin e internetit nga fëmijët e tyre adoleshentë. Pjesëmarrësit ishin 798 prindër suedezë (307 baballarë, 491 nëna) dhe fëmijët e tyre adoleshentë (të moshës midis 13 dhe 15 vjeç). Rezultatet tregojnë se shqetësimet e prindërve ndryshojnë, në aspekte të caktuara, sipas moshës dhe gjinisë së fëmijës. Për më tepër, aftësitë e prindërve në internet, përvoja e përdorimit të internetit dhe qëndrimet ndaj internetit, lidhen me llojin dhe natyrën e shqetësimeve të tyre. Prindërit që më parë kanë hasur përvoja negative të fëmijëve të tyre në internet janë ata që janë më të shqetësuarit (*Emma Sorbring.2014*). Sipas studimit tonë sa i përket këtij aspekti vërehet se të gjithë prindërit pjesëmarrës në anketim, 100%, janë të shqetësuar për aktivitetin e fëmijëve të tyre në internet.

Nga hulumtimi ynë u pa se 95% e prindërve të adoleshentëve, pjesëmarrës në studim, pohuan se fëmijët e tyre posedojnë telefon celular, ndërsa vetëm 5% e tyre e mohuan që fëmijët e tyre kanë telefon celular. Studimi i realizuar në SHBA tregon se disa fëmijë më të vegjël se 12 vjeç kanë telefonin celular të tyre. Pothuajse një në pesë prindër të një fëmije 11 vjet ose më të ri (17%) thonë se fëmija i tyre ka smartphone-in personal. Ekzistojnë dallime në pronësinë e smartphone -ve të fëmijëve sipas nivelit arsimor të prindërve dhe moshës së fëmijës. Prindërit me arsim të mesëm ose më pak, kanë dy herë më shumë gjasa se prindërit që janë të diplomuar në kolegji të thonë se fëmija i tyre ka smartphone -in e tyre (21% kundrejt 11%). Prindërit me fëmijë më të mëdhej në moshë gjithashtu kanë më shumë gjasa të thonë se fëmija i tyre ka telefonin e vet personal.

Për shembull, 37% e prindërve të një fëmije të moshës 9 deri në 11 vjeç thonë se fëmija i tyre ka smartphone -in e tyre, krahasuar me 13% të atyre me një fëmijë 5 deri në 8, 5% të atyre me një fëmijë 3 deri në 4 dhe 3% të atyre me një fëmijë që është 2 vjeç ose më i vogël (Brooke,A,Monica.A,Erica.T, 2020).

Hulumtimi i botuar në revistën Pediatrics përfishiu 350 fëmijë të një komuniteti pakicë me të ardhura të ulëta. Gjetjet vunë re një "eksponim pothuajse universal" ndaj pajisjeve mobile, duke treguar se lukset e tilla teknologjike nuk janë të kufizuara në familjet e pasura

financiarisht. Në fakt, edukimi i prindërve dhe gjinia dhe përkatësia etnike e fëmijës nuk luanin rol nëse një fëmijë zotëronte një telefon celular ose pajisje tjetër. Rol më të rëndësishëm në këtë aspekt luajnë prindërit që mbështeteshin në pajisje të tilla për fëmijët e tyre ndërsa bënin punët e shtëpisë, ishin jashtë në vende publike ose bënin punë tjera. Përveç kësaj, 28 % e prindërve thanë se përdorin një pajisje celulare për t'i vënë fëmijët në gjumë. Hulumtimi gjithashtu zbuloi se shumica e familjeve të anketuara kishin televizorë (97 përqind), tableta (83 përqind) dhe smartphone (77 përqind). Pak më shumë se gjysma kishin video tastierë (56 përqind), një kompjuter (58 përqind) dhe qasje në internet në shtëpi (59 përqind) (Jenny S. Radesky.2020) .

5.2. Përfundime dhe rekomandime

Në ditët e sotme janë adoleshentët ata që mbeten përdoruesit më të mëdhej internetit. Parë në këtë këndvështrim, interneti duhet vlerësuar jo si një teknologji por si një kulturë dhe kur flasim për kulturën, ajo nuk mund të formësohet brenda një kohe të shkurtër dhe duhet të kalojë në një proces evoluimi.




Figura 5: Përballja e mundësive të ofruara nga teknologjia me kulturën e përfitimit të tyre

Interneti është në të vërtetë një “oqean mundësish”, por ai duhet të konsumohet në mënyrë të moderuar e të ekuilibruar, dhe e gjithë kjo varet nga kultura dhe mënyra e sjelljes së njerëzve. Interneti përfshin një pjesë të madhe të jetës së adoleshentëve, të cilën arrijmë ta vërtetojmë në bazë të të dhënave të grumbulluara ku 94% e adoleshentëve e përdorin internetin në bazë ditore, 95% e adoleshentëve posedojnë telefon personal, ndërsa 72% prej tyre janë antarë të ndonjë rrjeti social.

Fëmijët sot po rriten në një epokë të përvojave të përdorimit të mediave shumë të personalizuar. Prandaj, prindërit duhet të inkurajohen që të zhvillojnë plane të personalizuar të përdorimit të mediave familjare për familjet e tyre që marrin pjesë në moshën, shëndetin, temperamentin dhe fazën e zhvillimit të çdo fëmije dhe të sigurohen që çdo fëmijë të mund të praktikojë dhe të përfitojë nga gjërat thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm, të tilla si një dietë e shëndetshme, higjienë e mirë gjumi, aktivitet fizik i përshtatshëm dhe ndërveprime pozitive shoqërore. Prindërit duhet t’i njohin dhe t’i kuptojnë rolet e tyre në modelimin e përdorimit dhe ekuilibrit të përshtatshëm të medias midis kohës së medias dhe veprimtarive të tjera.

Siç u pa nga studimi ynë, shumica dërmuese e adoleshentëve kanë qasje në internet dhe prindërit janë në masë të madhe në dijeni për aktivitetet e tyre online.

Sa i përket përdorimit të internetit gjatë ditës, javës dhe muajit, arritëm të shohim një përfshirje online të madhe të adoleshentëve në botën virtuale.

Kontrolli dhe menaxhimi i aktivitetit online i adoleshentëve nga ana e prindërve është pothuajse jo egzistues ngase vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre e ndjekin aktivitetin e tyre .

Gjithashtu vertetua se prindërit shprehin një shqetësim të madh nga rrëzimet potenciale të aktivitetit online të adoleshentëve, dhe se përdorimi i internetit ndikon në sjelljen e tyre të përditshme .

Sipas hulumtimit tonë, u vërtetua se prindërit kanë nivel të ulët të qasjes në internet dhe njëherit kontroll të ulët të aktivitetit online të adoleshentëve. Rekomandojmë organizimin e programeve dhe shfrytëzimin e softveleve të posaçme për edukimin kontinual të tyre në këtë drejtim. Duke i vënë në funksion të lartëpërmendurat, pretendojmë se do të ketë përdorim më të arsyeshëm të internetit dhe botës virtuale nga ana e adoleshentëve.

Ky studim është i limituar për arsye se është bazuar vetëm në një komunë të caktuar.

Referencat

- Enti shtetëror i statistikave mbi treguesit statistikor mbi përdorimin e internetit (Makstat)
- Wu, C., Wong, H. T., Yu, K. F., Fok, K. W., Yeung, S. M., Lam, C. H., & Liu, K. M. (2016). Parenting approaches, family functionality, and internet addiction among Hong Kong adolescents. *BMC pediatrics*, 2016
- Valkenburg, P. M., Peter, J., & Schouten, A. (2005). Adolescents' identity experiments on the Internet. *New media and Society*.
- Valkenburg, P. M., & Peter, J. (2007). Preadolescents' and adolescents' online communication and their closeness to friends. *Developmental Psychology*.
- Thomollari, D., (2012) INTERNETI DHE SHOQERIA. Kah kultivimi sociologjik të internetit. Plejad
- World Internet Project, International Report, fourth edition (www.worldinterproject.net)
- Pew Internet Project's research on teens. (September 2012 survey). Teens Fact Sheet.
- Norris. P., (2001) Digital Divide? Civic Engagement, Information Poverty and the Internet Worldwide. Cambridge: Cambridge University Press.
- Laudon, Kenneth C., and Jane Price Laudon. *Management Information Systems: New Approaches to Organization and Technology*. 5th ed. Upper SaddleRiver, NJ: Prentice Hall, 1998.
- Orleans, M., & Laney, M. C. (2000). Children's computer use in the home: Isolation or sociation? *Social Science Computer Review*.
- EU Kids Online Deliverable D4: Core findings to the European Commission Safer Internet Programme (13 January 2011). Risks and safety on the internet: The

perspective of European children. Full findings and policy implications from the EU Kids Online survey of 9-16 year olds and their parents in 25 countries.

- Loprinzi PD, Davis RE. Secular trends in parent-reported television viewing among children in the United States, 2001-2012. *Child Care Health Dev.* 2016
- Yolanda (Linda) Reid Chassiakos, Jenny Radesky, Dimitri Christakis, Megan A. Moreno, Corinn Cross and COUNCIL ON COMMUNICATIONS AND MEDIA
- Pediatrics November 2016, 138 (5) e20162593; <https://doi.org/10.1542/peds.2016-2593>
- Felt LJ, Robb MB. *Technology Addiction: Concern, Controversy, and Finding a Balance.* San Francisco, CA: Common Sense Media; 2016)
- .(Brasel SA, Gips J. Media multitasking behavior: concurrent television and computer usage. *Cyberpsychol Behav Soc Netw.* 2011)
- (Moreno MA, Gannon KE Social media and health. In: Rosen D, Joffe A, eds. *AM STARs Adolescent Medicine: State of the Art Reviews.* Young Adult Health. 2013
- Brenner J, Smith A. 72% of Online Adults are Social Networking *Site Users.* Washington, DC: Pew Internet American Life Project; 2013
- Kabali HK, Irigoyen MM, Nunez-Davis R, et al. Exposure and use of mobile media devices by young children. *Pediatrics.* 2015 Jernigan DH, Rushman AE. Measuring youth exposure to alcohol marketing on social networking sites: challenges and prospects. *J Public Health Policy.* 2014.
- Brown A; Council on Communications and Media. Media use by children younger than 2 years. *Pediatrics.* 2011.
- Subrahmanyam & Greenfield, 2008
- Tim Berners-Lee, *Weaving the Web*, 1999
- Science Media Medium
- John Naughton, *A Brief History of the Future: The Origins of the Internet*, 1999

- Miller P, Plant M. Parental guidance about drinking: Relationship with teenage psychoactive substance use. J Adolesc.
- Patterson GR, Stouthamer-loeber M. The correlation of family management practices and delinquency. Child Dev.
- Joseph Johnson. Internet usage of teenagers in the United States - Statistics & Facts, 2021
- Silvana Karacic, Stjepan Oreskovic. Internet Addiction Through the Phase of Adolescence: A Questionnaire Study.
- Tsai CC, Lin CC. Taiwanese adolescents' perceptions and attitudes regarding the internet: exploring gender differences. Adolescence. 2004
- Teens Today Spend More Time on Digital Media, Less Time Reading on: <https://www.apa.org/news/press/releases/2018/08/teenagers-read-book>
- Emma Sorbring. Parents' Concerns About Their Teenage Children's Internet Use. <https://doi.org/10.1177/0192513X12467754>, 2014
- Parenting Children in the Age of Screens on: <https://www.pewresearch.org/internet/2020/07/28/parenting-children-in-the-age-of-screens>
- Jenny S. Radesky, Heidi M. Weeks, Rosa Ball, Alexandria Schaller, Samantha Yeo, Joke Durnez, Matthew Tamayo-Rios, Mollie Epstein, Heather Kirkorian, Sarah Coyne and Rachel Barr. Young Children's Use of Smartphones and Tablets. Pediatrics July 2020.
- Brooke,A,Monica.A,Erica.T, Parenting children in the age of screens 2020
- Entertainment Software Association
- 2015 Sales,Demographic, and Usage Data. Essential Facts About the Computer and Video Game Industry. Washington, DC: Entertainment Software Association; 2015)
- Iglowstein, Jenni, Molinari&Largo, 2003
- Van den Bulck , 2004

- <https://www.apa.org/news/press/releases/2018/08/teenagers-read-book>
- <http://www.stat.gov.mk/Default.aspx>
- www.privacy.mk
- www.metamorphosis.org.mk
- www.bezbednonainternetorg.mk
- www.nemrazi.mk